



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:013371

Datë: 12.04.2021

Numri i dokumentit: 01678561

P.nr.26/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shkurte NekaJ-Januzaj, në lëndën penale kundër të pandehurit S. V. nga f.sh.K., i akuzuar për vepër penale “ Dëmtimi i të drejtave të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II.nr.2157/20 të datës 22.01.2021, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.**24.03.2021** në praninë e Prokurorit të Shtetit, Dorijan Juniku, të akuzuarit S. V., përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës KRK- G. M., Gjykata t njëjtën ditë në praninë e palëve mori dhe publikisht shalli, ndërsa me dt.12.04.2021, e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **S. V.** i biri i H., dhe nënës Xh. e vajzërisë G., i lindur me ne f.sh. K-....., ku edhe banon, i martuar baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë,23.11.2018, në fshatin,K., me qellim të pengimit të realizimit të së drejtës pronësore, tjetërson sendin në pronën e tij në të cilën personi tjetër ka të drejtën e pengut, dhe me këtë i shkakton dem personit të tillë, në atë mënyrë që pasi i pandehuri në njërin anë si debitor kishte lidhur kontratën për kredinë me nr. Koby-002505-002, me të dëmtuarën Kreditimi Rural i Kosovës, (KRK) në anën tjetër si kreditor, për shumën e kredisë prej 7.000 (shtatë mijë) euro, si dhe marrëveshjen për kolateralin e lënë peng, dhe atë 1(një) traktor të tipit IMT-539, 3(tri) krerë lopë qumështore të llojit “ “ Veglat bujqësore si 1 (një) rimorkio me plug, i njëjti nuk i ka kryer obligimet ndaj të dëmtuarës KRK-së, lidhur me pagesën e kësteve në vlerë prej 2.419.10, euro, e deri në pagesën definitive, ashtu që me rastin e daljes në teren të përmbauesit privat Gj. R. në shtëpinë e të pandehurit është konstatuar se ky i fundit ka tjetërsuar të gjithë pengun e sipërshënuar, përveç rimorkios dhe plugut.

- me çka ka kryer vepër penale “Dëmtimi i të drejtave të personit tjetër. nga neni 344 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,41,42,43,46,73,74, si dhe nenit 332 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 359,360,361,365,366,450 dhe 463 të KPPRK-së,

E gjykon me:
DENIM ME GJOBË
Ashtu që:

1.Të pandehurit **S. V.** Gjykata i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **400 (katërqind) euro**, të cilin dënim, duhet ta paguaj në afatin ligjor prej **15 ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, apo nuk mund ta paguajë gjobën e lartë shqiptuar sipas afatit të dhënë nga Gjykata, atëherë e njëjta gjobë do të zëvendësohet me burgim konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku (njëzetë) 20 euro të gjobës, do ti llogaritet në një ditë burgim.

3.I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej **30 (tredhjet) euro**, paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzetë) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 (tridhjetë) euro**, të gjitha këto ti paguajnë në afatin ligjor prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

4.Perfaqesurit e autorizuar i të dëmtuarës, (KRK) Kreditimi Rural i Kosovës SHPK, me seli në Prishtinë rr. Rexhep Mala nr.4, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritë aktakuzën, me PP/II.nr.2157/20 e datës 22.01.2021, kundër të pandehurit S. V. nga f. K, duke e akuzuar për veprë penale “Dëmtim i të drejtave të personit tjetër ” nga neni 344 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 16.02.2021, ne pranin e prokurorit te shtetit Arben Hoti dhe te pandehurit S. V. ku pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i pandehuri u deklarua i pafajshëm lidhur me veprën penale me të cilën është akuzuar, i njëjti njëkohësisht ka heqë dorë nga kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimi i provave, gjykata ka caktuar menjëherë seancën gjyqësore për dt.24.03.2021.

Shqyrtimi gjyqësore është mbajtur me datë 24.03.2021, ne praninë e prokurorit te shtetit Dorjan Juniku, te pandehurit S. V., dhe përfaqësuesve te autorizuar të dëmtuarës KRK-V. T. dhe G. M., në këtë seancë të gjitha palët e kanë paraqitur fjalën e tyre hyrëse, janë administruar provat e propozuara sipas aktakuzës e ka dhen mbrojtjen e tij i pandehuri dhe të gjitha palët e kanë paraqitur fjalën e tyre përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroj se: pas administrimit te provave materiale dhe personale gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor u vërtetua përtej dyshimit te bazuar mirë se i akuzuari S. V. është kryes i veprës penale “ dëmtimi i të drejtave te personit tjetër” nga neni 344 par 1 të KPRK-së, dhe këtë fakt e bazojmë në vet deklaratën e te akuzuarit në fjalë i cili gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor e pohoj faktin se me te dëmtuarën KRK ne Istog, ka lidhur kontratë për kredi me dt.05.04.2017 për shumën prej 7000 euro, po ashtu e

pohon se i ka lexuar te gjitha kushtet e kësaj kontrate respektivisht edhe nenin 5.5.3 në të cilin çart përcaktohet se ne rast te vonesave nga ana e kredi marrësit, ne pagesën e kryegjësë dhe kamatës se arritur, kredi marrësi do te paguaj penalltinë me normë prej 0.5% ne ditë të anuitetit ne vonës te kryegjësë, për 10 ditët e para te çdo muaji, po ashtu i njëjti nuk e mohoj se nuk e ka nënshkruar edhe marrëveshjen e kolateralit te lenë peng ku si pasuri te luajtshme ka lenë një traktor IMT 539, tri lopë qumështorë te llojit, veglat bujqësore si një rimorkio dhe një plug, e për te cilat lidhur me pronësinë e tyre ka dëshmuar duke nënshkruar edhe dëshminë mbi pronësi e gjësendeve te cekura si me lart, e për te cilat ka garantuar se gjësendet e lartshënuara do te mbesin ne pronësinë e tij deri ne përmbushjen e te gjitha obligimeve sipas kontratës kreditore.

Se i akuzuari kishte filluar te dështon ne kthimin e prestimeve ndaj kreditorit këtu te dëmtuarës KRK-së, dega Istog shihet edhe nga provat materiale siç janë vërejtja apo aneksi me nr.20 me te cilën i tërhiqet vërejtja se ne çoftë se brenda një dite nga pranimi i kësaj vërejtje nuk e bën pagesën totale te borxhit të KRK-së, do te detyrohet te bej përgatitjen e vërejtjes para padisë për çka e dëmtuara ndaj këtu te akuzuarit parashtron edhe vërejtjen para padisë si aneks nr.21 për te vazhduar me pas me dërgimin e njoftimit për fillimin e procedurës gjyqësore e qe për vërejtjet në fjalë dhe njoftimin edhe vet i akuzuari e pohoj se KRK, i kishte ndërmarr veprimet e cekura si me lart. Nuk është kontestues fakti se i akuzuari S. V. ka kryer vepër penale për te cilën akuzohet dhe kjo shihet nga procesverbalet e përpiluara dt.26.05.2019 dhe 23.11.2019 P.nr.1024/18 nga te cilat konsiston se me rastin e daljes ne vend te ngjarjes respektivisht ne shtëpinë e te akuzuarit si debitor përmbaruesi privat ne bazë të urdhrin te propozuar nga e dëmtuara KRK- dega Istog, ne te dy rastet nuk e kanë hasur fare te akuzuarin ne fjalë, veç djalin e tij A. V. i cili kishte pohuar se përveç plugut dhe rimorkios pjesën tjetër te kolateralit te len peng nuk e kishin më në posedim gjë qe le te kuptohet qe te njëjtin e kishin tjetërsuar. Prandaj pa mëdyshje u vërtetua, se i akuzuari S. V. me veprimet e tij te përshkruara si ne dispozitivin e aktakuzës ka konsumuar te gjitha elemente konstituivë te figurës se veprës penale nga neni 344 par 1 të KPRK-së, për çka nga gjykata kërkoh qe te njëjtin ta shpallni fajtor ta dënoni sipas ligjit si dhe ta obligoni ne paguarjen e shpenzimeve te procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës G. M. ne fjalën përfundimtare deklaroj se mbështes ne tersi fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit gjithashtu me tutje deklaroj ose shtoj se i akuzuari pas ballafaqimit me kontratën e kredisë i njëjti u pajtua me shumen e këstit te kredisë te cilat paraprakisht i kontestoj, gjithashtu përmes dëshmisë mbi pronësinë e gjësendeve te dhëna si kolateral-peng i njëjti ka qen i informuar për pasojat ne rast qe behet tjetërsimi i pengut, ne bazë të kësaj deklarate i akuzuari bashkërisht me anëtarin e familjes bashkëshorten Sh. H. janë zotuar se sendet e lëna peng do te mbesin ne pronësi të tyre deri ne përfundimin e obligimeve sipas kontratës se kredisë, pas mos pagesës se kësteve te kredisë nga ana e debitorit tani te akuzuarit, e dëmtuara KRK-së, ne pamundësi të përmbushjes se borxhit me vullnetin e tani e akuzuarit i është drejtuar përmbaruesit privat për realizimin e borxhit përmes procedurës përmbarimore, pas daljes ne teren nga përmbaruesi se bashku me zyrtarin e KRK-së, për kolektimin e kredive te këqija është konstatuar se kolaterali është shitur dhe nuk e ka në pronësi më i akuzuari kështu qe nga te gjitha provat e administruara në këtë lëndë si dhe në bazë të dëshmisë se të akuzuarit është vërtetuar se i njëjti ka kryer vër penale për te cilën akuzohet, kërkoh nga gjykata qe te njëjtin ta shpallë fajtor për veprën te cilën akuzohet si dhe i njëjti te mare dënimin komform kodit penal dhe kodit te procedurës penale duke i marr parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese lidhur me veprën te cilën e ka kryer.

I pandehuri S. V. ne fjalën përfundimtare deklaroj: se nuk e ndiej veten fajtor për veprën penale për te cilën akuzohem përkundrazi KRK-ja, me ka dëmtuar pasi qe mi ka qit te paguaj këstin prej 1700 euro.

PROVAT E ADMINISTRUARA

Gjatë shqyrtimit kryesorë në cilësinë e provave materiale janë administruar, deklarata e të pandehurit S. V. e dhënë në polici me dt.16.01.2021, kontrata për kredi me nr.KOBU-002505-002, deklarata mbi konfirmimin e adresës dhe vendbanimit, marrëveshja e kolateralit e dt.05.04.2017, dëshmia mbi pronësinë e gjësendeve të dhëna si kolateral e dt.05.04.2017, 14.fotografitë nga shkresa të lëndës kryesisht të mjeteve të punës në bujqësi, traktorit me rimorkio dhe gjedheve në stallë, tri pasaportat e gjedheve me nr.1144788, 1144787, 1144786, vërejtja e KRK-së, e dt.24.09.2018, vërejtja para padisë e KRK-së, e dt.01.10.2018, propozimi i KRK-së, për përmbarim i dt.19.10.2018, procesverbalet e përmbaruesit privat P.nr.102418/18 e dt. 23.11.2018, dhe 26.08.2019.

I pandehuri ne mbrojtjen e tij deklaroj se: nuk e di kohen e saktë kur e ka marr kredinë në bankën KRK-së, me seli në Istog, por di që diku para tri viteve apo katër, i njëjti ka marr kredi në vlerën prej 10.000 euro për bujqësi dhe atë tri here brenda dy vitesh, herën e parë i ka marr 5.000 euro te cilat kam pasur mi kthyer për tri vite, herën e dytë kam marr 2.000 euro dhe herën e tret kam marr kredi prej 3000, unë mjetet bujqësore dhe lopët i ka shti në kolateral-peng për garantimin e kredisë së parë prej 5.000 euro, ndërsa për kredinë e dytë prej 3.000 si kolateral i kam lanë në bankë një kamionët por atë e ka paguar me kohë, dhe kanë mbet ta paguaj kredinë prej 5.000 dhe 2.000 euro, që me janë bashkuar dhe me janë bërë 7.000 euro për te cilat ratën ne muaj e kam paguar prej 170,euro, dhe ne fund kanë mbet diku edhe 2.000 euro pa i paguar, unë e kam pas planin e pagesës për çdo muaj ka 170 euro por një ratë me ka ardh 1.700 euro dhe unë nuk kam pas mundësi që ta paguaj dhe pastaj kam ardhë deri te bllokimi për shkak te mos pagesës.

VLËRSIMI I PROVAVE:

Gjykata i ka falur besimin e plotë provave materiale të administruara siç janë: deklarata e të pandehurit S. V. e dhënë në polici me dt.16.01.2021, kontrata për kredi me nr.KOBU-002505-002, deklarata mbi konfirmimin, marrëveshja e kolateralit e dt.05.04.2017, dëshmia mbi pronësinë e gjësendeve të dhëna si kolateral e dt.05.04.2017, 14(katërmbëdhjetë) fotografitë nga shkresa të lëndës kryesisht të mjeteve të punës në bujqësi, traktorit me rimorkio dhe gjedheve në stallë, tri pasaportat e gjedheve me nr.1144788, 1144787, 1144786, vërejtja e KRK-së, e dt.24.09.2018, vërejtja para padisë e KRK-së, e dt.01.10.2018, propozimi i KRK-së, për përmbarim i dt.19.10.2018, procesverbalet e përmbaruesit privat me P.nr.102418, i dt.23.11.2018, dhe 26.08.2019.

Gjykata ka gjetur që provat materiale të administruara janë në harmoni të plotë edhe me deklarinë e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës KRK-së, G. M., ku gjatë seancës Gjyqësore, deklaroj se si i akuzuari pas ballafaqimit me kontratën e kredisë i njëjti u pajtua me shumen e këstit të kredisë të cilat paraprakisht i kontestoj, gjithashtu përmes dëshmisë mbi pronësinë e gjësendeve të dhëna si kolateral peng i njëjti ka qen i informuar për pasojat në rast që behet tjetërsimi i pengut, në bazë të kësaj deklarate i akuzuari bashkërisht me anëtarin e familjes bashkëshorten Sh. H. janë zotuar se sendet e lëna peng do të mbesin në pronësi të tyre deri në përfundimin e obligimeve sipas kontratës së kredisë, pas mos pagesës së kësteve të kredisë nga ana e debitorit tani të akuzuarit e dëmtuara KRK-së, në pamundësi të përmbushjes së borxhit me vullnetin e tani të akuzuarit i është drejtuar përmbaruesit privat për realizimin e borxhit përmes procedurës përmbarimore, pas daljes në teren nga përmbaruesi së bashku me

zyrtarin e KRK-së, për kolektimin e kredive te këqija është konstatuar se kolaterali është shitur dhe nuk e ka në pronësi më i akuzuari.

Gjykata pjesërisht i ka falë besimin edhe mbrojtjes se të pandehurit i cili nuk e mohoj faktin se me të dëmtuarën KRK, me seli në Istog, si kredi dhënëse ka lidhë kontratën e kredisë në vlerën prej 7000, euro, dhe po atë ditë ka lidhë edhe marrëveshjen e kolateralit me të dëmtuarën ku si peng ka lënë një traktor IMT-539, tri lopë qumështore, si dhe vegla bujqësore rimorkio dhe një plug për lavrimin e tokës, dhe i njëjti deklaroj se i ka lexuar të gjitha pikat e kontratës i ka kuptuar ato dhe ka qenë në dijeni për vonesat e kthimit të kredisë dhe pasojat që i sjellin ato në pagesën e penalltive prej 05%.

Gjykata nuk i fali besimin mbrojtjes se të pandehurit i cili nder të tjera deklaroj unë e kam pas planin e pagesës për çdo muaj ka 170 euro por një rastë me ka ardh 1700 euro dhe unë nuk kam pasur mundësi që ta paguaj dhe pastaj kam ardhë deri te bllokimi për shkak te mos pagesës.

Pretendimi i tij se gjoja nuk e ka ditur se për këstin e 10 (dhjet) të kredisë ka qenë i obliguar që ti paguaj bankës shumën e parave prej 1700 euro, është i pa bazuar pasi që ai me rastin e nënshkrimit të kontratës për kredi e ka marrë një kopje të saj ku në nenin 7 të kësaj kontrate janë të cekura pasojat e mos kthimit me kohë të kredisë ku është obliguar të paguaj penallti prej 0.5 %, dhe sipas marrëveshjen për kredinë e marrë sendet e lartcekura të lëna kolateral-peng, ka pas për obligim që mos ti shesë- tjetërsoj deri në përmbushjen e kredisë ndaj të demtuarses.

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se i pandehuri në cilësinë e kredi marrësit me dt.05.04.2017 në zyrën e Bankës për Kreditim Rural të Kosovës në Istog, si kredi marres ka nënshkruar kontratën për kredi me nr.KOBU-002505-002, dhe atë në shumën prej 7.000 euro me normë të kamatës vjetore prej 20% dhe me afat të kthimit prej 30 muajsh, ku të njëjtën ditë ai ka nënshkruar edhe marrëveshjen e kolateralit-pengut, për sigurimin e kredisë, ku si kolateral-peng, ai ka lënë: një traktor IMT-539, tri lopë qumështore, si dhe vegla bujqësore rimorkio dhe pllugj, të gjitha në vlerë prej 8400 euro, i njëjti nuk e mohon faktin se është pronar legjitim i sendeve të lëna kolateral-peng, dhe me dt.24.09.2018 atij i është bërë vërejtja me shkrim nga Banka, për shkak të vonesave në kthimin e kredisë, të cilën edhe e ka nënshkruar. Pastaj ai nga Banka është njoftuar edhe për fillimin e procedurës gjyqësore me dt.09.10.2018 të cilin e ka nënshkruar, si dhe faktit se herën e dytë kur përmbaruesi privat ka shkuar në shtëpinë e tij me dt.23.11.2018,dhe 26.08.2019, të njëjtin nuk e kanë gjetur në shtëpi por nga djali i tij A. V. janë informuar se i pandehuri i ka tjetërsuar sendet e lëna peng, si dhe nuk mohon faktin se për këstin e 10 dhjet të kredisë ka qenë i obliguar që ti paguaj 1700 euro, ku i njëjti e ka kundërshtuar me pretendimin se nuk i kujtohet që ta ketë parë këstin e 10 dhjet për pagesë në shumë prej 1700 euro, ndërsa nuk e mohon faktin se kur e ka lidhur kontratën e kredisë ka qenë i njoftuar se në rast te vonesave të kthimit të kredisë është obliguar të paguaj penale prej 0.5 % si në marrëveshjen për kredinë e marrë, dhe i njëjti nuk e mohon faktin se sendet e lartcekura të lëna kolateral ka pas për obligim që mos ti shesë.

Pas administrimit të provave një nga një dhe lidhshmërisë dhe krahasimit të tyre më njëra tjetrën, gjykata ka ardhë deri të vërtetimi i gjëndjes faktike se i pandehuri S. V. me datë 23.11.2018, në fshatin,K., me qellim te pengimit të realizimit të së drejtës pronësore, tjetërson sendin në pronën e tij në të cilën personi tjetër ka të drejtën e pengut, dhe me këtë i shkakton dem personit të tillë, në atë mënyrë që pasi i pandehuri në njërën anë si debitor kishte lidhur kontratën për kredinë me nr. Kobu-002505-002, me të dëmtuarën Kreditimi Rural i Kosovës, (KRK) në anën tjetër si kreditor, për shumën prej 7.000 euro, si dhe marrëveshjen për kolateralin e lënë peng, dhe atë 1(një) traktor të tipit IMT-539, 3(tri) krerë

lopë qumështore të llojit “ “ Veglat bujqësore si 1 (një) rimorkio me plug, i njëjti nuk i ka kryer obligimet ndaj të dëmtuarës KRK-së, lidhur me pagesën e kësteve në vlerë prej 2.419.10, euro, e deri në pagesën definitive, ashtu që me rastin e daljes në teren të përmbaruesit privat Gj. R. në shtëpinë e të pandehurit është konstatuar se ky i fundit ka tjetërsuar të gjithë pengun e sipërsënuar, përveç rimorkios dhe plugut.

Andaj nga vërtetimi i gjendjes faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata pa dyshim ka gjete se në veprimet e të pandehurit S. V. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “dëmtim i të drejtave të personit tjetër, ” nga neni 344 par.1 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale Gjkata ka ardhë në përfundim se i pandehuri ketë vepër penale e ka kryer me dashje pasi që i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe ka dëshiruar kryerjen e saj.

Sa i përket përgjegjesisë penale gjykata ka gjete se ndaj të njëjtit nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të tij, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën penale që i vihet në barrë.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin Gjkata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimeve gjyqësore, nuk ka dëshmi që i njëjti me parë ka qenë i dënues për vepra penale, ndërsa Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, gjykata ka ardhë në përfundim së dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje të plotë me shkallën e përgjegjesisë penale të tij, si dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është e bindur së vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitës së nenit 463 të KPPK-së, gjykata e udhëzoi përfaqësuesin e palës së dëmtuar në kontest civil.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL
P.nr.26/21 më datë 24.03.2021.

**Bashkëpunëtorja profesionale
Shkurte Nekaj-Januzaj**

**Gjyqtari Gjykues
Arben Mustafaj**

KËSHILLA JURIDIKE:

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës se Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.